



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 66 datë 30.12.2015

**Për
“INDEKSIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT QYTETËS NË BASHKINË E
TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 10, pika 3/I, shkronja “d”, nenit 32, pika “n” dhe nenit 33, pika 2 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 10, shkronja “c”, nenit 12, shkronja “a”, nenit 14, nenit 85, paragrafi i tretë të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 761, datë 12.11.2014 “Për shfuqizimin e vendimit nr. 637, datë 21.5.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit qytetas të udhëtarëve, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar”; vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr.25, datë 16.05.2006 “Mbi përcaktimin e linjave të transportit qytetas të udhëtarëve, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe ripërcaktimi i stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Indeksimin e tarifave të transportit qytetas në Bashkinë e Tiranës, si më poshtë:
 - 1.1 Tarifat e transportit qytetas të udhëtarëve me autobus në Bashkinë e Tiranës, në linjat me largësi deri në 9 km, janë:
 - 1.1.1 Për një udhëtim vajtje ose kthim 40 (dyzetë) lekë, (duke përfshirë dhe TVSH).
 - 1.1.2 Për biletë pajtimi mujor, për një linjë 1200 (një mijë e dyqind) lekë; (duke përfshirë dhe TVSH).
 - 1.1.3 Për biletë pajtimi mujor, të përgjithshëm për të gjitha linjat, 1600 (një mijë e gjashtëqind) lekë (duke përfshirë dhe TVSH).
 - 1.1.4 Për biletë pajtimi mujor, të përgjithshëm, për studentët, për të gjitha linjat, 600 (gjashtëqind) lekë, (duke përfshirë dhe TVSH).
2. Çmimi vlerësohet dhe indeksohet çdo vit mbështetur në inflacionin e deklaruar zyrtarisht, kjo nëse indeksimi krijon një vlerë të shkëmbyeshme në raport me monedhën lekë sipas formulës:

- 2.1** Çmimi i biletës rritet ose zvogëlohet me 5 lekë nëse indeksimi me inflacionin e çmimit ekzistues është më i madh ose barazim me 75% e vlerës shtesë ose minus nga 0 deri në 5 lekë.
- 2.2** Çmimi i biletave të pajtimit mujor rritet ose zvogëlohet me 50 lekë nëse indeksimi me inflacionin e çmimit ekzistues është më i madh ose barazim me 75% e vlerës shtesë ose minus nga 0 deri në 50 lekë.
- 2.3** Nëse raporti i mësipërm nuk përputhet, atëherë indeksimi nuk bëhet, por vazhdohet në çdo vit pasardhës duke e përlogaritur në mënyrë progresive deri sa të mundësohet indeksimi në përputhje me formulën e mësipërme.
- 2.4** Ngarkohet Kryetari i Bashkisë që të aprovojë indeksimin mbi bazën e formulës së mësipërme.
- 3.** Sistemi i biletimit dhe kartelave të pajtimit do të jetë elektronik.
- 4.** Në biletimin elektronik kategoritë e personave që përfitojnë udhëtime falas si dhe studentët do të pajisen me karta të personalizuar.
- 5.** Deri në aplikimin e sistemeve elektronike operohet sipas standarteve aktuale të biletimit dhe kartelave të pajtimit.
- 6.** Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, si dhe Operatorët e transportit qytetës në Bashkinë e Tiranës.
- 7.** Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi fillojnë nga 1 shkurt 2016.
- 8.** Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI